



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Nenit 15 të Ligjit Nr. 08/L-193. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 04.04.2023 me 01Nr.401-11924/23, me rekomandimin e KPF-së të datës 14.04.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt për vitin 2023, të mbajtur me datën: 28.04.2023 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për transfer të mjeteve brenda organizatës buxhetore nga kategoria mallra dhe shërbime (Kodi 130) fondi burimor 10 dhe Ri-alokimi i mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale , fondi burimor 10.
2. Transferi i mjeteve buxhetore bëhet nga programi Arsim dhe Shkencë (920), nën-programi Administrata e Arsimit (92090), kodi funksional (0980) transferohet nga kategoria ekonomike Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej 6,000.00 € në programin Administrata dhe personeli (163), nën-programin Administrata dhe personeli (16318) me kod funksional (0133) në kategorinë ekonomike Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10.
3. Ri-alokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale , fondi burimor 10, në kuadër të programit Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nën-programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (66395), kodi funksional (0620) nga projekti “Bashkëfinancim me donatorë”, kodi i projektit (48267) shuma 7,820.00 € ri-alokohet në projektin “Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në fshatin Qeskovë” kodi i projektit (51445).
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;

01Nr. 06-14840 /23
Klinë, me 04.05 /23

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINË



Kryesuesi,
Fadil Gashi